



GALERIA KOMBËTARE E KOSOVËS - QAFA HAP THIRRJEN PËR PROGRAMIN VJETOR 2026

Galeria Kombëtare e Kosovës - QAFA, ju fton të aplikoni në thirrjen e hapur për Programin Vjetor 2026. Përmes kësaj thirrje mirëpresim propozime për ekspozita ndërdisiplinare (duke përfshirë mediumin e pikturës, skulpturës, grafikës, instalacionit, fotografisë, videos, performancës, etj.) si dhe për projekte edukativo-arsimore, hulumtuese, botuese, multimediale. Ekspozitat dhe projektet mund të implementohen brenda ose jashtë objektit të GKK- QAFA, në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me stafin e galerisë. Inkurajohen projekt propozimet nga artistë dhe kuratorë, organizata dhe komunitete kulturore (kontratat lidhen me individë), hulumtues dhe praktikues tjerë të arteve pamore.

Afati i fundit për aplikim është **23 dhjetor, 2025**.

Si të aplikoni?

Aplikacionet dorëzohen online në info@galeriakombetare-rks.com si PDF, Google Drive ose WeTransfer.

Opsionale: Të dorëzohen fizikisht në adresën Galeria Kombëtare e Kosovës - QAFA, Rr. UÇK, nr. 15, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 10:00–16:00.

Shënim: Nuk pranohen punimet (veprat e artist) fizike.

Aplikuesi/ja duhet të jetë qytetar/e i/e Republikës së Kosovës.

Materialet dhe dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formulari i plotësuar të cilin mund ta gjeni [këtu](#)
- Projekt propozim (max. 1000 fjalë) ku sqarohet vizioni/qëllimi i projektit/ekspozitës, detajohet formati (instalacion, video, performancë, skica, animacion 3D, fotografi, etj.)
- Reproduksion vizual (fotografi, video, skica, animacion) i punës dhe vizualizim i vendosjes së veprave në galeri (e preferueshme).
 - Gjeni [këtu](#) planimetrinë e hapësirës ekspozuese në GKK QAFA. Kurse [këtu](#) mund të gjeni një pamje 360° të një ekspozite të mëparshme, që ju mundëson të keni një prespektivë më të qartë të hapësirës.
- Biografi e shkurtër (max. 400 fjalë)
- Portofolio dhe CV, ose Webfaqe
- Dokument identifikues i Republikës së Kosovës



- Buxheti:
 - Për ekspozita dhe punë artistike: Buxheti i parashikuar në linja vetëm për prodhimin e punës (deri në 5,000 EUR).
 - Për projekte tjera: Buxheti i parashikuar në linja të ndara për secilin aktivitet dhe i specifikuar në kohë.
- Propozim për planifikimin kohor të implementimit të aktiviteteve të projektit.

Buxhetet do të negociohen dhe finalizohen sipas mundësive dhe kërkesave pas përzgjedhjes së projekteve.

Periudha e aplikimit: **22 tetor – 23 dhjetor, 2025**

Shpallja e projekteve të përzgjedhura: **Në fund të janarit, 2026**

Juria/ Këshilli i GKK-së: Renea Behluli, Agron Blakçori, Bariu Zenelaj, Guri Çavdërbasha, Somer Şpat, Linda Gusia.

Ku të marrim më shumë informata?

Personi kontaktues në GKK për këto aplikacione është Elsa Morina, *Administratë*.

E-mail: info@galeriakombetare-rks.com

Tel: +383 (0) 38 225 627